



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.1493 prot.

Tepelenë, më 25.08.2025

Lënda: Njoftim për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit të Bashkisë Tepelenë.

KËSHILLTARËVE TË BASHKISË

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË ZNJ. JULINDA KARTERI

Sheshi "Lord Bajron", Tepelenë.

Të nderuar Këshilltarë,

Ju njoftoj se ditën e premte më datë 29.08.2025, ora 11:00, në Pallatin e Kulturës Tepelenë (kati i dytë) do të zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetari i Këshillit në bazë të Neni 53, Pika 4 e Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe "Rregullores së funksionimit të Këshillit Bashkiak", me rend dite si vijon:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve së kaluara datë 31.07.2025.
3. **Projektvendim:** "Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Korrik 2025".
4. **Projektvendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Korrik 2025".
5. **Projektvendim:** "Për miratimin e Planit të Arsimit Parauniversitar të Bashkisë Tepelenë 2026-2028"
6. **Projektvendim:** "Për miratimin e Planit Social Vendor dhe Planit të Veprimit 2025-2029 Bashkia Tepelenë"
7. **Projektvendim:** "Për emërtim rruge në Njësinë Administrative Qëndër, Bashkia Tepelenë"

8. **Projektvendim:** “Për miratimin e Projekt marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis njësive të vetqeverisjes vendore dhe Këshillit të Ministrave për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, Akademia e trajnimit të njësive të vetqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë.(TALGA)
9. **Projektvendim:** “Për vënien në dispozicion të një mjedisi pune në shkollën ‘Sinan Kërpi’, në përdorim të Kryesisë së fshatit Lekdush, Njësia Administrative Kurvelesh.”
10. Informacion mbi masat e marra për përgatitjen e ambienteve shkollore për fillimin e vitit të ri shkollor 2025-2026, në institucionet e arsimit parashkollor, parauniversitar, konvikte, çerdhe, kopshte, si dhe qendrat sportive në Bashkinë Tepelenë.
11. Informacion mbi kontrollin dhe zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në kontratat e qirasë: “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” dhe “Për dhënien në përdorim të tokës bujqësore të pandarë”, për kontratat e lidhura me afat të gjatë.
12. Çështje të tjera

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË

Arben GUMENI

